



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:226262  
Datë: 15.01.2025  
Numri i dokumentit: 06714579

Pml.nr.777/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarve: Q. L., nga Gj. dhe D. T., nga fshati ..., komuna e Gj., për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. lidhur me nenet 31 dhe 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit Q. L., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, 2023:226262, datë 24.07.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1419/2024, datë 15.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit Q. L., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, 2023:226262, datë 24.07.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1419/2024, datë 15.10.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin e lartcekur, i ka shpallur fajtor të dënuarit: Q. L., dhe D. T., për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. lidhur me nenet 31 dhe 77 të KPRK-së dhe ndaj secilit prej tyre ka shqiptuar dënime me burgim në kohëzgjatje prej nga një (1) vit dhe dënime me gjobë në shumë prej nga njëmijetëqind (1.800) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa në dënimet me burgim, të dënuarve do t’ju llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 23.10.2023 deri më datën 21.02.2024. Nëse të dënuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund t’i paguajnë dënimet me gjobë, atëherë dënimet me gjobë do të zëvendësohen në dënime

me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim me shumën prej njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, përkatësisht për nëntëdhjetë (90) ditë burgim për secilin nga të dënuarit. I dëmtuari M. B., nga Gj., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Të dënuarit janë detyruar që secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga tridhjetë (30) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej nga 20 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës prerë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1419/2024, datë 15.10.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar dhe ankesat e mbrojtësve të të dënuarve, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit Q. L., avokati Urim Pozhegu, ku nga përmbajtja e kërkesës, rezulton se është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për shqiptimin e dënimeve, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe t'i ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që ndaj të dënuarit të shqiptojë dënime dukshëm më të buta, apo dënim me kusht ose çështja penale të kthehet në rigjykim.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.443/2024, datë 30.12.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 6, 7 dhe 8 të KPP-së, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, në pjesën e dispozitivit është edhe i paqartë dhe konfuz. Dënimet e shqiptuara janë të rënda, ngase jo vetëm se kanë ekzistuar arsye arsyet për shqiptimin e dënimeve më të buta, por janë përmbushur edhe të gjitha kushtet nga nenet 48 dhe 49 të KPRK për shqiptimin e dënimit me kusht, duke i pasur parasysht një numër të madh të rrethanave posaçërisht lehtësuese. Në këtë drejtim, pretendohet se gjykatat e instancave më të ulëta kanë shkelur ligjin penal të dëm të të dënuarit nga neni 387 të KPP-së, pasi që nuk kanë zbatuar dispozitat ligjore të neneve 71 dhe 72 të KPRK, ngase i dënuari e ka pranuar fajësinë sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë para ngritjes së aktakuzës, është i prind i tre (3) fëmijëve të mitur dhe mbajtës i familjes, ka gjendje të dobët ekonomike dhe se detyrimi në pagimin e gjobës do t'ia rrezikonte seriozisht mirëqenien ekonomike-familjare.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit Qerqiz Lila.

Mbrojtësi i të dënuarit Q. L. në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nuk ka specifikuar konkretisht se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale që ndërliken me nenin 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 6, 7 dhe 8 të KPP-së, përveç se i përmend si të tilla. Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vërejtur që aktgjykimet e kundërshtuara të jenë përfshirë me shkelje të këtyre dispozitave të procedurës penale, pasi që dispozitivi i aktgjykimeve në fjalë është i qartë dhe nuk është kundërthënë, ndërsa në arsyetimet e tyre janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat, përkatësisht çështjet e rëndësishme, andaj edhe si të tilla, këto aktgjykime rezultojnë se janë përpiluar konform dispozitave përkatëse ligjore nga neni 369 dhe neni 404, paragrafi 1 të KPP-së. Në veçanti, është e rëndësishme që të theksohet se në arsyetimin e aktgjykimimit të gjykatës së shkallës së dytë janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta në lidhje me vlerësimin e pretendimeve thelbësore ankimore të paraqitur ankesat e përfaqësuesit të palës së dëmtuar dhe të mbrojtësve të të dënuarve.

Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron të pabazuar edhe pretendimin e mbrojtësit të të dënuarit Q. L., në lidhje me shkeljen e ligjit penal, pasi që gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë tejkuluar kompetencat e tyre ligjore me rastin e shqiptimit të dënimeve, dënime këto të cilat janë shqiptuar në kuadër të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, që ishte nënshkruar nga palët dhe në kuadër të kornizave përkatëse ligjore. Në këtë drejtim, sa i përket çështjes së shqiptimit të dënimeve më të buta, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton se sipas dispozitës së nenit 385, paragrafi 5 të KPP-së, kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal konsiderohen vetëm rastet kur në marrjen e vendimit për dënimin, gjykata ka tejkuluar kompetencat ligjore. Ndërsa, në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar rrethanat përkatëse relevante dhe duke e patur në konsideratë marrëveshjen për pranimin e fajësisë, të dënuarit Q. L., i ka shqiptuar dënimet përkatëse, brenda kufijve të parashikuara me ligj për veprën penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, çka do të thotë se nuk janë tejkuluar kompetencat ligjore. Përkundrazi, ndaj të dënuarit Q. L., duke e pasur në konsideratë arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, është shqiptuar dënim me burgim nën minimumin e parashikuar me ligj, pasi që për veprën penale “Vjedhja e rëndë”, nga neni 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPRK-së është parashikuar dënim me gjobë dhe dënim me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjetëve, kurse ndaj të dënuarit në fjalë është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti. Kjo do të thotë se në këtë rast, është zbutur dënimi nën minimumin e parashikuar me ligj, ndërsa një mundësi e tillë është parashikuar në nenin 71, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPRK-së dhe vjen në shprehje në rastet kur i pandehuri e pranon fajësisë ose ka arritur marrëveshje për pranimin, siç është situata me rastin konkret.

Përndryshe, edhe në këtë çështje penale, Gjykata Supreme e Kosovës rithekson se matja e dënimeve dhe vlerësimi i rrethanave përkatëse relevante është në kompetencë të gjykatës së

shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, varësisht nga rrethanat e rastit, ndërsa duke u bazuar në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së, këto pretendime në lidhje me shqiptimin e dënimeve më të buta, nuk mund të jetë arsye për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në këtë mënyrë, nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

Pml.nr.777/2024, më 14.01.2025

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Rasim Rasimi